

**FEDERATA E BOKSIT  
E KOSOVËS**



**BOXING FEDERATION  
OF KOSOVA**

Tel/Fax: +383 38 247 578; Mob: +383 44 112824,44 208 215 E-mail: [fboxk@hotmail.com](mailto:fboxk@hotmail.com)  
Adress: Str. Agim Ramadani no: 43, House of Sport I flour no3, 10000 Pristina, Kosova  
NLB Bank No: 1701001010850503

Në bazë të nenit 30 nënpika 8,9 e Statutit të Federatës të Boksit e Kosovës, Bordi i FBOXK-se, në mbledhjen e vet të mbajtur më 18.06.2022 miratoi këtë:

## **RREGULLORE**

**PËR REGJISTRIMIN E KLUBEVE, SPORTISTVE, STATUSI DHE  
TRANSFERI I TYRE**

**Prishtinë 18.06.2022**

## **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

### **Neni 1**

Me rregulloren për regjistrim (në tekstin e mëtejshme rregullohet procedura dhe mënyra e regjistrimit të klubeve, sportiste, trajnerëve, gjyqtarëve, personave të tjerë (kryetarëve, përfaqësuesve, mjekëve, teknikëve mjekësorë, etj. të klubeve), mënyra e kalimit të sportistëve prej klubit në klub dhe e drejta për pjesëmarrje në gara të FBOXK-së, e drejta për paraqitje në gara të nënshtetasve të huaj për klube anëtare të FboxK-së, e drejta për pjesëmarrje të sportistëve të Kosovës nëpër klube të jashtme, si dhe Libri i regjistrimit dhe mënyra e udhëheqjes.

## **II. PARAQITJA DHE REGJISTRIMI I KLUBEVE**

### **Neni 2**

Për tu anëtarësuar një klub në FBOXK, duhet ti plotësojë këto kushte :

1. Ta paraqet Kërkesën për anëtarësim (regjistrim) në FBOXK,
2. Kërkesës t'ia bashkëngjetë procesverbalin e kuvendit të vet konstituiv, me regjistrin e emrave të anëtarëve të Kryesisë së Klubit,
3. Kërkesës t'ia bashkëngjetë kopjen e Statutit të klubit, i cili nuk duhet të jetë në kundërshtim me Statutin dhe aktet të tjera normative të FBOXK-së,
4. Të ketë regjistrimin si OJQ pranë organit përgjegjës të komunal, si dhe vendimin mbi regjistrim pranë organit kompetent komunal (Drejtorisë së Sportit) si klub publik apo privat.
5. Të paguaj shumën për regjistrimin e klubit, lartësinë e së cilës e cakton Bordi i FBOXK-së, me vendim të posaçëm.
6. Të regjistrojë në FBOXK jo më pakë se 10 sportist,
7. Të disponojë palestrën ne të cilin dëshmohet se kryen aktivitetet stërvitore

### **Neni 3**

Klubet që plotësojnë kushtet nga nenet 2 të kësaj Rregulloreje. FBOXK-ja lidhur me kërkesat e kompletuara për Regjistrimin e klubeve, në afat prej 15 ditësh nga data e dorëzimit të tyre, duhet të vendos Komisioni për Regjistrimin e sportistëve dhe klubeve. Dhe pas plotësimit të kushteve për regjistrim, kuvendi FBOXK-se vendos për pranimit të klubit të ri në FBOXK. Pas pranimit në kuvend të FBOXK-se ,FBOXK është e obliguar që t'i lëshoj vendimin klubit në formë të shkruar për pranimit në FBOXK.

#### **Neni 4**

Klubi është i obliguar që çdo vit të ripertirne licencimin - anëtarësimin, dhe ate para fillimit të edicionit të ri të garave.

Me rastin e ripertirjës së licencës – anëtarësi së klubi është i obliguar që të përmbushë pagesën në shumë prej 100 € (Kotizim) ,sipas vendimit të Bordit të FBOXK-së.

Zyra e FBOXK-së bënë vertetimin e licencës – anëtarësisë konform nenit 2 dhe 8 të Rregullores mbi regjistrimin e klubeve, sportistve statusi dhe transferin e tyre.

#### **Neni 5**

Çdo regjistrim në Regjistrin e klubeve të Federatës së Boksit të Kosovës, duhet të ketë edhe vulën e FBOXK-së.

#### **Neni 6**

Klubi pushon të jetë anëtarë i FBOXK-së, në bazë të vendimit të Kuvendit të Klubit, apo sipas dispozitave të akteve normative të FBOXK-sëqë e parashohin këtë:

- Largimin nga Federata,
- Shuarja e veprimtarisë dhe
- Ndalesës së punës dhe veprimtarisë

### **III. PARAQITJA DHE REGJISTRIMI I SPORTISTVE**

#### **Neni 7**

Anëtarë të klubit janë:

- sportist
- personat zyrtarë dhe
- të tjerë

#### **Neni 8**

Çdo klub është i obliguar që një herë në vjet, të ripërtërijë licencën – anëtarësinë për anëtarët e saj.

Me rastin e pagesës së anëtarësisë, shuma e të cilës caktohet nga Bordi i FBOXK-së, vertetimi i anëtarësisë dhe licencimi bëhet nga zyra e Federatës së Boksit të Kosovës.

Të gjithë anëtarët e FBOXK-së, gjyqtarët, trajnerët, dhe të tjerë obligues të regjistruar në FBOXK-ë janë të obliguar të posedojnë librezat e anëtarësisë dhe rregullisht të i përmbushin obligimet e antarësisë. Shuma e pagesës së antarësisë për një vit garues është:

1. Libreza për sportist 5 €,
2. Licencimi për sportist/Sportiste 5 €,
3. Libreza e trajnerit 5 €,
4. Anëtarësia e trajnerit 50 €,
5. Libreza e gjyqtarit, dhe persona ve zyrtar 5 €,
6. Për librezat e tjera 5 €
- 7.

#### **Neni 9**

Çdo regjistrim dhe licencim i anëtarëve të Federatës së Boksit të Kosovës duhet të vërtetohet me vulën e FBOXK-së.

#### **Neni 10**

Sportisti i cili me dëshirën e vet e zgjedh klubin, regjistrimin për të mund ta bëjë prej moshës 6-vjeçare, nën kushte të parapara sipas kësaj rregulloreje, me ç'rast pranon obligimet, të drejtat dhe detyrat e parapara me akte normative të FBOXK-së.

Për Sportistin nën moshën 18 vjeç, bashkëngjitur dokumentacionit për regjistrim, duhet të jetë edhe pëlqimi i njërit prej prindërve apo kujdestarit .

#### **Neni 11**

Regjistrimin e sportistëve të klubeve të Kosovës e bën Komisioni për regjistrim, i emëruar nga Bordi i FBOXK-së.

#### **Neni 12**

Asnjë Sportist nuk mund të regjistrohet për dy apo më shumë klube në të njëjtën kohë.

Anëtarësia e Sportistit për një klub dokumentohet në bazë të regjistrimit paraprak.

Sportisti i cili në afat kalimtar e nënshkruan fletëregjistrimin për dy apo më shumë klube, me dokumentacion komplet apo jo komplet pa pëlqimin e klubit amë nuk ka të drejtë pjesëmarrje në gara dhe regjistrim në klub tjetër një vitë (1) dhe humb të drejtën e kalimit nga klubi amë dhe do të mbetet anëtar i tij deri në afatin e ardhshëm kalimtar dhe për këtë sanksionohet në bazë të dispozitave të Rregullores disiplinore të FBOXK-së.

#### **Neni 13**

Përrjashtim bëhet për sportistet që nuk janë të licencuar në vitin paraprak nga klubi amë

#### **Neni 14**

Sportistet të cilët e kanë fletë statusin e Sportistit të lirë , mund të regjistrohen për klubin e ri edhe jashtë afatit kalimtar.

Sportist të cilët nuk kanë kontrata me klubet, dhe në afatin kalimtar nuk aplikojnë për kalim në ndonjërin klub apo status të Sportistit të lirë , mund të regjistrohen edhe pas afatit kalimtar vetëm me fletëlëshimin e klubit në të cilin ka pasur paraqitje në garën e fundit kampionate, për këtë përveç formularit , duhet bërë edhe pagesën në shumë prej 5 euro në xhirollogarinë rrjedhëse të FBOXK-së.

#### **Neni 15**

Për Sportistin i cili për herë të parë regjistrohet, klubi i cili dëshiron ta regjistrojë është i obliguar që Komisionit për regjistrim t'ia paraqesë këtë dokumentacion :fletëkërkesën e Sportistit, së cilës duhet bashkëngjitur edhe kërkesën e klubit në formë të shkruar në dy kopje , certifikatën e lindjes, dy fotografi të madhësisë 3x4 cm, jo më të vjetra se gjashtë muaj, vërtetimin mbi pagesën e bërë prej 5 euro në xhirollogari gjegjëse të FBOXK-së, për sportist që kanë garuar në botën e jashtme është e obligueshme international transfer certificate - pëlqimi i federatës ku ka garuar më parë dhe vërtetimi mbi pagesën e bërë prej 50 euro në xhirollogarinë gjegjëse të FBOXK-së.

#### **Neni 16**

Për Sportistin që kalon prej klubit në klub, klubi i cili dëshiron ta bëjë regjistrimin, Komisionit për regjistrim duhet parashtruar këtë dokumentacion :

- fletëkërkesën e Sportistit, së cilës duhet bashkëngjitur edhe kërkesën e klubit për regjistrim, të shtypura në dy kopje,
  - fletëpëlqimin prej klubit paraprak apo vendimin e organit gjegjës të atij klubi se Sportisti është i lirë për ta ndërruar klubin apo vendimin e organit të shkallës së dytë të FboxK-së për shkëputjen e kontratës me kërkesë të Sportistit, të cilën klubi paraprak nuk ia ka dhënë në afatin e rregullt, librezën e anëtarësisë nga klubi paraprak, në të cilën duhet të jetë e evidencuar data dhe koha e çregjistrimit nga klubi paraprak me një fotografi të madhësisë 3x4 cm, jo më të vjetër se gjashtë muaj,
  - certifikatën e lindjes.
- vërtetimin mbi pagesën e bërë prej 30 euro në xhirollogarinë e BOXK-së.

#### **Neni 17**

Për sportistët kosovarë që kalojnë nga ndonjë klub i jashtëm në ndonjë klub të Kosovës, Komisionit për regjistrim duhet parashtruar këtë dokumentacion:

- fletëkërkesën e Sportistit me kërkesë të klubit për regjistrim në formë të shkruar në dy kopje,
- pëlqimin e federatës gjegjëse që i takon klubit nga i cili vjen Sportisti,
- fletëçregjistrimin nga klubi paraprak me dëshmi se nuk ka kurrfarë obligimi ndaj tij,
- dy fotografi të madhësisë 3x4 cm, që nuk është më e vjetër se gjashtë muaj,

vërtetimin mbi pagesën e bërë prej 30 euro në xhirollogarinë gjegjëse të FBOXK-së për regjistrim,

- certifikatën e lindjes

- vërtetimin mbi pagesën e bërë prej 100 euro në xhirollogarinë të FBOXK-së për sportist që vijnë nga klubi i ndonjë federate të jashtme në klub kosovar.

#### **Neni 18**

Komisioni për regjistrimin e sportistëve është i obliguar që ta shqyrtojë dokumentacionin e kompletuar më së largu në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit, përkatësisht nga dita e kalimit të afatit kalimtar.

Klubi, përkatësisht Sportisti që nuk e parashtron dokumentacionin e kompletuar duhet të udhëzohet që në afat prej 5 ditësh ta kompletojë atë, në të kundërtën kërkesa do të refuzohet.

#### **Neni 19**

Komisioni për regjistrim është i obliguar që pas shqyrtimit të kërkesave për regjistrim, me shkrim ta njoftojë administratën e FBOXK-së në mënyrë që ajo ta bëjë regjistrimin e sportistëve, si dhe atyre t'ua lëshojë librezat garuese, duke i evidencuar në librin e evidencës.

#### **Neni 20**

Formën dhe përmbajtjen e librezës garuese e përcakton me akt të posaçëm Bordi i FBOXK-së.

#### **Neni 21**

Në qoftë se librezat garuese humbet apo bëhet e pavlefshme, klubi i drejtohet administratës së FBOXK-së për ta lëshuar duplikatin e saj.

### **IV. KALIMI I SPORTISTVE - NDËRRIMI I ANËTARËSISË**

#### **A. AFATI KALIMTAR**

#### **Neni 22**

Sportisti prej klubit në klub mund të kalojë vetëm në afatin kalimtar njëher në vitë.

Sportisti pa kontratë apo Sportisti me status të Sportistit të lirë prej klubit në klub mund të kalojë edhe jashtë afatit kalimtar.

#### **Neni 23**

Dallojmë afatin e rregullt kalimtar.

## **Neni 24**

Afati i rregullt kalimtar është njëher në vitë. Fillimi dhe përfundimi i afatit kalimtar caktohet me vendim të posaçëm të Bordit të FBOXK-së.

## **B. PROCEDURA E PARAPARË PËR KALIMIN E SPORTISTIT PREJ KLUBIT NË KLUB**

### **Neni 25**

Procedura për kalimin e Sportistit prej klubit në klub është:

Sportisti paraqet kërkesë me shkrim për lëshimin e fletëçregjistrimit në afatin kalimtar drejtuar klubit anëtar i të cilit është në formë të shkruar me dëshmi për pranimin e saj. Klubi të cilit i është drejtuar Sportisti është i obliguar që në kërkesën e shkruar në afat prej 8 ditësh të përgjigjet me sa vijon:

- ta lëshojë fletëçregjistrimin
- të mos e lëshojë fletëçregjistrimin, duke e arsyetuar vendimin e vet me shkrim.

### **Neni 26**

Në qoftë se klubi tetë ditë nga dita e marrjes së kërkesës nga ana e Sportistit nuk përgjigjet në kërkesë të tij, konsiderohet se Sportisti nuk ka pengesë për t'u regjistruar në klub të ri.

Në qoftë se klubi përgjigjet me shkrim, duke e refuzuar Sportistin, është i obliguar që ta arsyetojë këtë refuzim, duke e udhëzuar Sportistin që për këtë t'i bëjë ankesë organit kompetent të FBOXK-së.

### **Neni 27**

Në kërkesë të drejtuar me shkrim nga ana e Sportistit për dhënien e fletëçregjistrimit klubi është i obliguar që ta pranojë atë në këto raste:

- në qoftë se Sportisti e ka paraqitur kërkesën në afat kalimtar,
- në qoftë se klubi në të cilin Sportisti dëshiron të kalojë e ka paguar kompensimin e paraparë në kontratë në mes të Sportistit dhe klubit nga i cili dëshiron të shkojë,
- në qoftë se e ka paguar kompensimin e paraparë me dispozitat gjegjëse për statusin e sportistëve në Kosovë,
- në qoftë se Sportisti nuk ka kurrfarë obligimesh të tjera ndaj klubit.

Formën dhe përmbajtjen e fletëçregjistrimit e përcakton bordi i FBOXK-së.

Pas lëshimit të fletëçregjistrimit të vlefshëm klubi në të më nuk mund të bëjë vërejtje

### **Neni 28**

Sportist dhe klubet mund të nënshkruajnë kontrata mes veti të cilat nuk mund të jenë më afat me të shkurtër se 12 (dymbëdhjeta) muaj dhe më shumë se 8 (tetë) vjet).

Çdo sportist, i cili nuk posedon kontratë të vlefshme llogaritet si sportist i lirë dhe mund të ndërrojë klubin në afatin e rregullte kalimtar.

Kontrata e nënshkruar për dymbëdhjetë muaj vlen deri në mbarimin e stinorit, do të thotë deri në afatin e rregullte ,pa marr parasysh se a kanë kaluar 12-të muaj.

Kontrata e nënshkruar për,2,3 apo 8-vite po ashtu vlen deri në mbarimin e kampionatit, dhe Sportisti-ja është e lirë në afatin kalimtar (të rregullte apo plotësues).

### **Neni 29**

Nëse vjen deri të fuzionomi(bashkimi) i dy klubeve, para përfundimit të afateve kalimtare të përcaktuara me Rregulloren e FBOXK-së mbi regjistrimin e klubeve sportistë e të dy klubeve kanë të drejt të garës për klubin e ri.

### **Neni 30**

Nëse Vjenë deri te shuarja e ndonjë klubi gjatë garave, ai klub fshihet nga regjistri i FBOXK-së, kurse sportistë kanë të drejt të regjistrohen në klubet tjera.

Nëse klubi shuhet para fillimit të garave për sezonin e ri, sportistet kanë të drejt të regjistrohen për klubin e ri edhe jashtë afatit kalimtar, sepse nuk janë fajtor për rrethanat e reja të krijuara në gara, dhe fitojnë të drejtën e garës 8 ditë pas fletëparaqitjes për regjistrim.

### **Neni 31**

Klubi nga i cili kërkohet fletëçregjistrimi ka të drejtë për kompensim nga klubi në të cilin dëshiron të kalojë Sportisti, nëse më parë me atë Sportist ka pasur kontratë të vlefshme, ku është cekur edhe kompensimi për të në rastet e kalimit të Sportistit në ndonjë klub tjetër. Kompensimi mund të rregullohet me marrëveshje dhe nëse klubi dhe Sportisti kanë pasur kontratë të vlefshme.

## **C. KUNDËRSHTIM PËR MOSLËSHIMIN E FLETËÇREGJISTRIMIT**

### **Neni 32**

Në qoftë se klubi të cilit i është drejtuar Sportisti për fletëçregjistrim përgjigjet negativisht apo në qoftë se klubet nuk mund të merren vesh për kushtet e kalimit të Sportistit, mund t'i paraqitet kundërshtim Komisionit për regjistrim.

Bashkëngjitur kundërshtimit paraqitet edhe:

- kopja e kërkesës së Sportistit për lëshimin e fletëçregjistrimit, duke e dokumentuar atë me kohë dhe datën kur është bërë kjo kërkesë,



- kopja e përgjigjes negative nga klubi,
- vërtetimi mbi pagesën e bërë prej 30 euro në xhirollogarinë gjegjëse të FBOXK-së në emër të kundërshtimit të bërë.

### **Neni 33**

Komisioni për regjistrim duhet të vendosë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së kundërshtimit, duke e njoftuar palën me shkrim me vendimin e këtij organi të bazuar në akte normative të FBOXK-së.

### **D. ANKESA NË VENDIMIN E KOMISIONIT PËR REGJISTRIM**

#### **Neni 34**

Në vendimin e Komisionit për regjistrim, si organ të shkallës së parë pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

Ankesa parashtrohet në administratën e FBOXK-së për komisionin e shkallës së dytë - Komisioni arbitrar (ky komision i ka tre anëtarë, të cilët i zgjedh bordi i FBOXK-së).

Ankesës i bashkëngjitet edhe vërtetimi mbi pagesën e bërë prej 30 euro në xhirollogarinë gjegjëse të FBOXK-së.

Komisioni arbitrar është i obliguar që të vendosë lidhur me këtë ankesë në afat prej 15 ditësh. Vendimi i komisionit arbitrar është i prerë.

### **E. E DREJTA NË PARAQITJE – GARË**

#### **Neni 35**

Sportisti ka të drejtë paraqitjeje – garë menjëherë pas regjistrimit:

- në qoftë se është i regjistruar për herë të parë,
- në qoftë se është i regjistruar në afatin kalimtar.

Sportisti ka të drejtë paraqitjeje – garë(5) pesë ditë pas regjistrimit në rastet si vijojnë:

- në qoftë se është i regjistruar me vendim të organit kompetent të FBOXK-së,
- në qoftë se deri në ditën e regjistrimit nuk ka qenë i lidhur me kontratë me ish-klubin e tij.
- në qoftë se është regjistruar edhe jashtë afatit kalimtar deri në ,por me pëlqimin e klubit amë.

#### **Neni 36**

Sportisti nuk ka drejtë të garës gjatë mbajtjes së dënimit nga organi kompetent i FBOXK-së.

#### **Neni 37**

Për klubet e Kosovës kanë të drejtë të regjistrohen numër i pakufizuar i sportistëve nënshtruar të huaj të regjistruar në bazë të kësaj rregulloreje, mirëpo të drejtë paraqitje në një gara kanë më së shumti 2 sportist (në procesverbal të një gare).

#### **Neni 38**

Në gara miqësore Sportisti mund të paraqitet për ekipin për të cilin nuk është i regjistruar me leje të klubit amë.

### **V. KONTRATAT NË MES TË KLUBEVE DHE SPORTISTVE**

#### **Neni 39**

Të drejtat dhe obligimet si dhe marrëdhëniet e tjera reciproke në mes të klubeve dhe sportistve rregullohen me kontratë, e cila duhet të lidhet më së paku me kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjeta) muaj e deri më së shumti 8 (tetë) vjet.

#### **SPORTIST - E PA KONTRATË**

#### **Neni 40**

Sportistet të cilët nuk kanë kontratë me shkrim me ekipet – klubet e tyre dhe të cilëve nuk iu është paguar kompensimi mbi dhe më tepër e shpenzimeve të nevojshme dhe të domosdoshme për paraqitje në gara, konsiderohen – trajtohen si sportist pa kontratë.

Shpenzimet e nevojshme dhe të domosdoshme të cilat Sportisti mund ti merr duke mos rrezikuar statusin e vet si sportist pa kontratë janë:

- shpenzimet e udhëtimit
- shpenzimet e vendosjes
- pajisjet sportive
- participimi për ushtrime

Sportisti – ja pa kontratë është i lire dhe në çdo kohë mund të kalon në ndenji ekip klub tjetër pa ndenji kusht të veçantë.

#### **SPORTISTI ME KONTRATË**

#### **Neni 41**

Sportist të cilët janë paguar më shumë se kompensimet e parapara me nenin 42 të kësaj Rregulloreje duhet të kenë kontratë me ekipin – klubin e tyre. Këta sportist konsiderohen – trajtohen si sportist me kontratë.

Ekipet – klubet janë të obliguara të dorëzojnë në Federatë formularin nr. 4 (statusin e sportistve). FBOXK-ja duhet të përpilojë regjistrin qendror të sportistëve nën kontratë.

## KONTRATAT

### Neni 42

Sportisti dhe ekipi-klubi mund të lidhin një nga këto dy tri kontrata:

1. Kontratë mbi perfeksionimin sportiv dhe stipendim
2. Kontratat amatore
3. Kontratë për paraqitje – garim si profesionist
- 4.

### Neni 43

Kontrata duhet të përmbajë të drejtat dhe obligimet e të dy palëve, dhe të njëjtës duhet ti përcaktohet afati i zgjatjes, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 12-të muaj, dhe as më i gjatë se 8-të vjet.

Kontratat e cila nënshkruhet për 12-të muaj. Vlen deri në afatin kalimtar (të rregullte) pa marrë parasysh datën e nënshkrimit, sepse ajo vlen prej një afati kalimtar deri në afatin tjetër kalimtar. Kontratat e nënshkruara me afate 1 vjeçare, dy vjeçare, tre vjeçare apo 8 vjeçare me mbarimin e sezonit për sa vite ka nënshkruar Sportisti, ai është i lire me fillimin e afatit kalimtar (të rregullte apo plotësues)

#### a). KONTRATA MBI PREFIKSIONIMIN SPORTIV DHE STIPENDIM

Kontrata për sportist mbi prefiksionimin sportiv dhe stipendim përmban:

- dispozitat mbi obligimet e ekipit-klubit lidhur me banimin, ushqimin, transportin lokal, sigurimin shpërblimet dhe kompensimet
- dispozitat lidhur me obligimet e Sportistit lidhur me ushtrimet dhe garat
- dispozitat lidhur me kohëzgjatjen e kontratës
- dispozitat mbi obligimin e Sportistit, lidhur me nënshkrimin e kontratës profesionale apo kontratës mbi garim si veprimtari shtesë
- dispozitat mbi kompensimin për kalim në ekip-klub tjetër vendor apo të jashtëm para kalimit të kontratës

#### b). KONTRATA PËR AMATORE

### Neni 44

Ekipet –klubet dhe sportistet-et e regjistruar për ta të cilët përveç boksit ushtrojnë edhe ndenji veprimtari tjetër plotësuese, mund të lidhin kontratë në mes tyre për garim në sportin e mundjes si amatorë.

### Neni 45

Kontrata për Ekipet –klubet dhe sportistet-et e regjistruar të cilët përveç boksit ushtrojnë edhe ndonjë veprimtari tjetër plotësuese, mund të lidhin kontratë në mes tyre për garim si sportist amatorë përmban:

- dispozitat mbi obligimet e ekipit-klubit lidhur me banimin, ushqimin, transportin lokal, sigurimin shpërblimet dhe kompensimet
- dispozitat lidhur me obligimet e Sportistit lidhur me ushtrimet dhe garat
- dispozitat lidhur me kohëzgjatjen e kontratës
- dispozitat mbi obligimin e Sportistit, lidhur me nënshkrimin e kontratës profesionale
- dispozitat mbi kompensimin për kalim në ekip-klub tjetër vendor apo të jashtëm para kalimit të kontratës.
- 

#### **Neni 46**

Kontrata si sportist amatorë nuk mund të lidhin sportistit më të rijnë se 18-të vjet.

Kjo kontratë mund të lidhet të nënshkruhet në kohëzgjatje prej 12-të muaj deri në 2 apo 8vjet.

E njëjta mund të shkëputet me marrëveshje para kalimit të afatit në dobi të nënshkrimit të kontratës profesionale.

#### **c). KONTRATA PROFESIONALE**

#### **Neni 47**

Sportist profesional trajtohen ata sportist, të cilët ekzistencën e vet e sigurojnë duke garuar në sportin e boksit.

#### **Neni 48**

Ekipi dhe Sportisti janë të lirë me rastin e nënshkrimit të kontratës profesionale, me të cilën rregullohen dhe obligimet ndërmjet tyre.

#### **Neni 49**

Kontrata profesionale e nënshkruar në mes ekipit dhe Sportistit përmban posaçërisht:

- të drejtat dhe obligimet e ekipit
- të drejtat dhe obligimet e Sportistit
- dispozitat lidhur me sigurimin shëndetësor, pensional dhe invalidor
- dispozitat lidhur me kohëzgjatjen e marrëdhnjëve kontraktuese
- dispozitat lidhur me kushtet e shkëputjes së kontratës
- dispozitat lidhur me kompensimin –dëmshpërblimin për kalim në ekip tjetër vendas apo të jashtëm pas kalimit të kontratës
- dispozitat me të cilat parashihet shkëputja e kontratës në rastet e mos përmbushjes së kushteve të saj
- dispozitat rreth kushteve financiare
-

#### **Neni 50**

Kontratë profesionale nuk mund të nënshkruajnë sportistet më të rinjë se 14-të vjet

#### **Neni 51**

Kontratat mund të nënshkruhen në afat prej 12 muaj deri në 2 – 8 vjet ( apo solucion më i përshtatshëm në mes ekipit dhe Sportistit)

#### **Neni 52**

Pas kalimit të kontratës profesionale, Sportisti është i lirë në zgjedhjen e ekipit.

Për Sportistin të cilit i ka kaluar-skaduar kontrata, ekipi ka të drejtë në kompensim-dëmshpërblim nga ekipi i ri deri në lartësinë e shumës së përcaktuar në kontratë, apo sipas kriteriumeve për dëmshpërblim të parapara në këtë Rregullore.

#### **Neni 53**

Pas kalimit të kontratës, Sportisti me kontratë e fiton statutin e Sportistit pa kontratë – Sportistit të lirë. Në rast të kalimit të Sportistit (tani Sportist pa kontratë) në ekip tjetër, ekipi prej të cilit shkon nuk ka të drejtë në kompensim , përveç në rastet kur kemi të bëjmë me precizimin e marrëdhënieve në kontratë apo tek sportistet nën moshën 18 vjeçare.

#### **Neni 54**

Përrjashtimet nga neni paraprak janë të mundshme:

Nëse ish Sportisti nën kontratë, nënshkruan kontratë të re në afat prej (12) dymbëdhjetë muajve nga skadimi – kalimi i kontratës së vjetër, dhe regjistrohet si Sportist nën kontratë konform me dispozitat e Rregullores mbi statusin e Sportistit, ekipi i cili i fundit e ka pasur atë Sportist nën kontratë ka të drejtë në kompensim-dëmshpërblim. Shuma e kompensimit (dëmshpërblimit) është përcaktuar me kontratën e fundit ose sipas kriterieve për dëmshpërblim konform me dispozitat e Rregullores mbi statusin e sportistëve.

#### **Neni 55**

Nëse ekipi i cili i fundit e ka pasur Sportistin nën kontratë dyshon në statutin e atij Sportisti në ekipin e ri mund të kërkojë nga Federata e Boksit e Kosovës – organeve përkatëse, sqarime konkrete dhe ndërmarrjen e masave të duhura.

#### **d) UDHËHEQJA, EVIDENCA E KONTRATAVE DHE KONTESTET**

### **Neni 56**

Statusin e Sportistit e udhëheq, evidenton dhe vërteton Komisioni për regjistrim pranë FBOXK-së, në afat prej 8 ditëve nga dita e nënshkrimit.

Formulari plotësohet në 3 ekzemplar – kopje të cilët i përcillen Komisionit për regjistrim në vërtetim, pastaj nga një ekzemplar (kopje) mbetet në dokumentacionin e FBOXK-së.

Kontratat të cilat nuk janë të regjistruara dhe evidentuara në regjistrin e Federatës së Boksit të Kosovës, nuk prodhojnë efekte të cilat Komisioni i garave – Komisioni i garave do të merrte parasys.

### **Neni 57**

Në qoftë se njëra nga palët kontraktuese mendon se pala tjetër nuk iu ka përmbajtur klauzolave qenësore të kontratës, mund të kërkoj shkëputjen e kontratës nga Komisioni për regjistrim i FBOXK-së.

Sportisti apo ekipi i cili kërkon shkëputjen e kontratës duhet të paraqet:

- Kërkesën për shkëputjen e kontratës të argumentuar me prova bindëse
- Kopjen e kontratës
- Vërtetimin mbi pagesën e shumës prej 30€ në llogari rrjedhëse të FBOXK-së.
- 

### **Neni 58**

Mbi kërkesën për shkëputjen e kontratës Komisioni për regjistrim i FBOXK-së, duhet të vendos në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.

Në vendimin e Komisionit për regjistrim, pala e pakënaqur ka të drejt ankese. Ankesa i paraqitet Komisionit arbitrar të FBOXK-së, në afat prej 8 ditëve nga marrja e vendimit, me pagesë të shumës prej 30 €.

Vendimi i Komisionit arbitrar është përfundimtar dhe ndaj tij nuk lejohet ankesa.

## **VI. KATEGORIZIMI I SPORTISTVE**

### **Neni 59**

Sportist janë të kategorizuar si vijon:

1. Sportist i kategorisë botërore (zgjat 4 vjet nga dita e fitimit të kë ti rangui)
  - fitimi i vendit të I – X – të në Lojërat Olimpikë , Kampionatet botërore, apo kampionatet evropiane
2. Sportist i kategorisë ndërkombëtare (zgjat dy vjet nga dita e fitimit të kë ti rangui)
  - për paraqitje në reprezentacionin kombëtar, në lojërat olimpikë, kampionatet botërore apo kampionatet evropiane
  - për fitimin e vendit të I – III – të në lojërat mediterane (Mesdheut), kampionatet ballkanike apo në universijada
3. Sportist i kategorisë kombëtare (zgjat një vjet nga dita e fitimit të statutit)

- Sportist të kësaj kategorije janë të gjithë ata Sportist, të cilët garojnë për kombëtare në lojërat olimpike, kampionate botërore dhe evropiane, pastaj mediterane, ballkanike, dhe univerzijada si dhe miqësore, me kusht që të jenë në listën e përzgjedhësit për tërë atë vit garues.
- 4. Sportist i kategorisë së juniorëve (zgjat një vjet nga dita e fitimit të statusit)
  - Sportist të kësaj kategorije janë të gjithë ata Sportist që garojnë për kombëtare në gara zyrtare të kombëtares sonë, apo edhe gara miqësore ndërkombëtare gjatë një viti, dhe gjenden në listën e përzgjedhësit të kombëtares.
- 5. Sportist i kategorisë së kadetëve (zgjat një vjet nga dita e fitimit të statusit)
  - Sportist të kësaj kategorije janë të gjithë ata Sportist që garojnë për kombëtare në gara zyrtare të kombëtares sonë, apo edhe gara miqësore ndërkombëtare gjatë një viti, dhe gjenden në listën e përzgjedhësit të kombëtares.
- 6. Sportist të regjistruar konform dispozitave të kësaj Rregulloreje

## **b). LEJA PËR REGJISTRIM DHE PARAQITJA NË EKIPIN E FEDERATËS TJETËR NACIONALE**

### **Neni 62**

Sportisti me kontratë mund të fiton lejen për lojë në ekipin e Federatës tjetër nacionale:

- nëse e ka fletë çregjistrimin e ekipit anëtarë i të cilit ka qenë deri atëherë
- nëse e ka paguar Certifikatën ndërkombëtar të transferim
- nëse e ka fletë çregjistrimin e Federatës anëtar i të cilës ka qenë apo është ekipi
- nëse e ka lejen e Bordit të FBOXK-së (për ata sportist të cilët janë kandidat për ndonjë seleksionim të përfaqësueses së Kosovës, regjistrin të cilin në çdo vit kalendarik e dorëzon përzgjedhësi i kombëtares)
- nëse ekipi i huaj ka nënshkruar marrëveshje me FBOXK-në, me të cilën obligohet që Sportisti gjegjë do të jetë në dispozicion të përfaqësueses sonë kombëtare në të gjitha garat zyrtare (si dhe përgatitjet rreth këtyre garave)
- nëse e ka paguar kompensimin – dëmshpërblimin ndaj klubit sipas marrëveshjes në kontratë
- nëse e ka fletë çregjistrimin e Federatës anëtar i të cilës ka qenë apo është ekipi

### **Neni 63**

Sportisti me kontratë i cili është më i ri se moshën 18 vjet mund të regjistrohet për ekipin e Federatës tjetër nacionale në qoftë se paraprakisht i plotëson të gjitha obligimet ndaj klubit me të cilin ka pasur kontratë me këto kushte:

- nëse e ka paguar kompensimin ndaj klubit në shumë prej 500 € për edicion të garave, në bazë të paraqitjeve në atë klub dhe i llogariten vitet e kaluara
- nëse ka paguar kompensimin ndaj FBOXK-së në shumë prej 500 € për një vit si sportist i përfaqësueses së Kosovës, dhe i llogariten të gjitha vitet sa ka qenë anëtarë i përfaqësueses së Kosovës
- nëse e ka paguar Certifikatën ndërkombëtar të transferimit .

## **VIII. HUAZIMI I SPORTISTVE**

#### **Neni 64**

Klubi ka të drejtë t'ia huazojë sportistët e vet klubit tjetër.

Huazimi i Sportistit bëhet me pëlqimin e tij, në mes të dy klubeve të interesuara për një kohë të caktuar e më së paku (6) muaj dhe kjo rregullohet me kontratë të posaçme në mes të klubeve dhe Sportistit.

Sportisti i cili huazohet në klubin tjetër nuk mund të ketë kontratë me klubin e ri, por i vazhdon kontratën me klubin më, dhe koha e kaluar në klubin e ri i llogaritet si anëtar i klubit më.

#### **Neni 65**

Sportisti mund të huazohet në afatin e rregullt kalimtar.

Pas përfundimit të afatit ,nuk lejohet huazimi.

Për Sportistin e huazuar klubi i interesuar duhet të paraqesë këtë dokumentacion :

- kontratën mbi huazimin e Sportistit, të nënshkruar dhe vërtetuar nga dy klubet si dhe pëlqimin me shkrim të Sportistit për huazim,
- dy fotografi të madhësisë 3x4 cm, jo më të vjetra se gjashtë muaj, vërtetimin mbi pagesën e bërë prej 30 euro në xhirollogarinë gjegjëse të FBOXK-së.

### **IX. KALIMI I SPORTISTVE NË KLUBE TË BOTËS SË JASHTME**

#### **Neni 66**

Sportistët kosovarë kanë të drejtë kalimi në klube të botës së jashtme në bazë të dispozitave pozitive ekzistuese të FBOXK-së, si dhe akteve ndërkombëtare të (IBA)

#### **Neni 67**

Për kalimin dhe fitimin e së drejtës në gara - paraqitje për ekipe të klubeve të botës së jashtme çdo Sportist kosovar është i obliguar ta kërkojë International Transfer Certificate nga FBOXK-ja duke paguar shumën prej 50 € euro në xhirollogarinë gjegjëse të FBOXK-së.

### **X. KALIMI DHE REGJISTRIMI I SPORTISTVE NGA KLUBET E BOTËS SË JASHTME NË KLUBET KOSOVARE**

#### **Neni 68**

Sportisti me nënshtetësi të huaj apo me nënshtetësi të dyfishtë mund të regjistrohet në çdo klub anëtar i FBOXK-së me procedurë të paraparë sipas akteve ndërkombëtare të AIBA-së.



Për një klub sipas alinesë paraprake gjatë një viti garues mund të regjistrohen numër i pakufizuar i sportisteve.

#### **Neni 69**

Për Sportist nënshtetas të jashtëm, i cili kalon nga ndonjë klub i jashtëm në klub kosovar, Komisionit për regjistrim duhet parashtruar këtë dokumentacion:

- fletëkërkesën e Sportistit me kërkesë të klubit për regjistrim në formë të shkruar në dy kopje ,
- Certifikatën ndërkombëtare të Sportistit të kërkuar nga klubi përmes formularit ,
- dy fotografi të madhësisë 3x4 cm, jo më të vjetra se gjashtë muaj,
- vërtetimin mbi pagesën e bërë prej 30 euro për regjistrim,
- vërtetimin mbi pagesën e bërë prej 100 euro në xhirollogarinë gjegjëse të FBOXK-së për sportist që vijnë nga klubet e jashtme.

#### **Neni 70**

Sportistit më nënshtetësi të huaj apo me nënshtetësi të dyfishtë mund të regjistrohet në çdo klub anëtar i FBOXK-së me procedurë të paraparë sipas akteve normative të FBOXK-së dhe atyre ndërkombëtare, sportistit me nënshtetësi të huaj apo me nënshtetësi të dyfishtë mund të regjistrohen:

- gjatë afatit kalimtarë të rregullte

-

### **XI. REGJISTRIMI I TRAJNERËVE, GJYQTARËVE DHE PERSONAVE TË TJERË ZYRTARË TË FBOXK-së**

#### **Neni 71**

Anëtar i FBOXK-së në cilësinë e trajnerit mund të bëhet çdo person që regjistrohet në administratën e FBOXK-së në librin gjegjës nën kushtet e parapara me aktet normative të FBOXK-së dhe Rregullores mbi licencim të Shoqatës së trajnerëve.

#### **Neni 72**

Librin e evidencës së trajnerëve e mban administrata e FBOXK-së nën kushtet e parapara me statut të Shoqatës së trajnerëve.

#### **Neni 73**

Anëtar i FBOXK-së në cilësinë e gjyqtarit mund të bëhet çdo person që e ka provimin e dhënë për kategoritë gjegjëse të parapara me Rregullore ndërkombëtare të boksit, me statutin e Shoqatës së gjyqtarëve dhe me aktet e tjera të FBOXK-së.

#### **Neni 74**

Librin e evidencës së gjyqtarëve dhe e mban administrata e FBOXK-së nën kushte e parapara me status të Shoqatës së gjyqtarëve .

#### **Neni 75**

Anëtar i FBOXK-sënë cilësinë e delegatit mund të bëhet çdo person që e ka provimin e dhënë për kategoritë gjegjëse të parapara me Rregullore ndërkombëtare të boksit, me statutin e Shoqatës së delegatëve dhe me aktet e tjera të FBOXK-së.

#### **Neni 76**

Librin e evidencës së delegatëve dhe e mban administrata e FBOXK-së nën kushte e parapara me status të Shoqatës së delegatëve .

#### **Neni 77**

Personat e tjerë, kryetarët e klubeve, përfaqësuesit zyrtarë të klubeve, mjeku i klubit e të tjerë janë persona që me dëshirë të veten bëhen anëtarë të klubeve dhe regjistrohen në kushtet e parapara në këtë rregullore dhe aktet normative të tjera të FBOXK-së në librin për regjistrimin e personave të tjerë.

#### **Neni 78**

Librin mbi evidencën e personave të tjerë e mban administrata e FBOXK-së nën kushtet e parapara me aktet normative të FBOXK-së.

Regjistrimin sipas nenit paraprak për personat e tjerë e bën Komisioni për regjistrim, të cilit duhet bashkëngjitur këtë dokumentacion:

kërkesën e klubit me shkrim për regjistrim të anëtarit të klubit në cilësinë e anëtarit, të shtypur në dy kopje, një fotografi të madhësisë 3x4 cm, vërtetimi mbi pagesën e bërë prej 5 euro në xhirollogarinë gjegjëse ose në arkën e FBOXK-së.

## **XII. LIBRI I EVIDENCËS DHE UDHËHEQJA E TIJ**

#### **Neni 79**

Në bazë të dispozitave të kësaj rregulloreje Komisioni për regjistrim i mban këto libra të evidencës:

libri i evidencës së sportistëve, libri i evidencës së trajnerëve, libri i evidencës së gjyqtarëve , libri i evidencës së delegatëve dhe libri i evidencës së personave të tjerë të FBOXK-së.

### **XIII. MBROJTJA E RREGULLORES**

#### **Neni 80**

Kundër Vendimit të Bordit të FBOXK-së lidhur me regjistrimin e Sportistit, pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtojë ankesë Gjykatës Komunale të Prishtinës.

Ndërkaq për mosmarrëveshjet klub – sportist dhe anasjelltas, të cilat nuk mund t'i zgjidhin organet e FBOXK-së, apo ne rastet kur vendimet e tyre njëra palë është e pakënaqur, kompetente është Gjykata e cila autorizohet në kontratën e lidhur ndërmjet klubit dhe sportistet (potencomi i gjykatës së autorizuar në kontratë është i obligueshëm).

### **XIV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 81**

Këtë rregullore e harton dhe e miraton Bordi i FBOXK-së ne mbledhjen e mbajtur me 18.06.2022

Kjo rregullore hyn ne fuqi ,duke filluar nga data e miratimit.

#### **Neni 82**

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen me procedurë të paraparë për miratimin e saj.

Kryetari i FboxK-së  
Enver Krasniqi



Prishtinë më 18.06.2022

